



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

Nr. 277 **Prot**

Tiranë, më 31.05.2021

Lënda: Lidhur me procesin e ngritjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve

Drejtuar: Kryetarëve të Shoqatave të Kineastëve

Të nderuar,

Qendra Kombëtare e Kinematografisë do të nisë procesin e krijimit të Këshillave të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor 2021-2023. Për t'i paraprirë këtij procesi, me qëllim që të mos kemi pengesa në vijimësinë e aktivitetit të institucionit, Ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Në mes të muajit Maj 2021 ka rifilluar puna për ndryshimet në ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", i ndryshuar. Me propozimet për ndryshimin e këtij ligji, ju do të njiheni gjatë një procesi konsultativ, që do të zhvillohet në një kohë të dytë.

Ndër propozimet ligjore është përfshirë edhe ndryshimi i mënyrës së ngritjes së KMP-ve, për të evituar gjithë problematikat e evidentuara, apo kontestimet për përbërjen e KMP-ve. Konkretisht është parashikuar ndryshimi i disa neneve, përfshi edhe nenin 9 të ligjit:

"Neni 9
Procedura e zgjedhjes së KMP-ve

KMP-të zgjidhen sipas kësaj procedure:

- a- Tre muaj përpara mbarimit të mandatit të KMP-ve aktualë, Kryetari i QKK-së bën publik fillimin e procesit për krijimin e KMP-ve të reja.
- b- Kryetari i QKK-së, në marrëveshje me përfaqësuesit e shoqatave të kineastëve përcakton kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të KMP-ve. Pas miratimit të kriterëve hapet thirrja për aplikime për anëtarë të KMP.
- c- Pas përfundimit të afatit të aplikimit, QKK përzgjedh listën e kandidatëve që përmbushin kriteret për anëtarët e KMP-ve të ardhshme.
- d- Lista e kandidatëve votohet nga kineastët, sipas parimit një anëtar një votë. Ka të drejtë të votojë cilido kineast që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.77. Tiranë
Tel. 04 2378 004

E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al
www.nationalfilmcenter.gov.al

e- Procesi i votimit zhvillohet on line dhe organizohet e administrohet nga QKK. Procedurat për realizimin e votimit përcaktohen në Rregulloren e QKK.

f- Kryetari i QKK, në bazë të renditjes përfundimtare të pikëve maksimale të marra gjatë votimit, miraton përbërjen e KMP-ve dhe i shpall ato publikisht përpara përfundimit të mandatit ligjor të KMP-ve paraardhëse.”.

Për t’i paraprirë ndryshimeve ligjore, duke arsyetuar që procedura e propozuar është më demokratike dhe më transparente, vlerësojmë kontributin dhe bashkëpunimin Tuaj për mendime dhe sugjerime për realizimin me sukses të procesit të zgjedhjes së KMP-ve.

Sa më sipër, QKK fton kryetarët e shoqatave të kineastëve në takim konsultativ me objekt:

1. Diskutimi dhe përcaktimi i kriterëve të kandidatëve për anëtarë të KMP-ve;
2. Diskutimi dhe përcaktimi i termit “Kineast”, që do të përcaktojë atë pjesë të komunitetit që do të kenë të drejtë për t’u regjistruar dhe çertifikuar nga QKK, për të votuar dhe zgjedhur KMP-të.

Takimi do të mbahet në ambientet e QKK, në datën 14 Qershor 2021, ora 11.00. Jeni të lutur që të merrni masa për të garantuar prezencën tuaj fizike në takim, si dhe të paraqesni propozime konkrete për sa është përcaktuar në rendin e ditës së takimit.

Ju falënderoj paraprakisht për bashkëpunimin.



Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.77. Tiranë

Tel. 04 2378 004

E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al

www.nationalfilmcenter.gov.al